




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjiçan
Gilan Belediyesi

Në mbështetje të nenit 12 paragrafsi 12.2 shkronja d), nenin 17 shkronja k), nenin 40.2 shkronja c) të Ligjit 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 28 Qershor 2008), nenin 37 pika 1.11, nenin 38 paragrafi 1.4, nenin 46 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Gjiçanit 01. nr. 16-126211 dt. 06.11.2014, me ndryshimet dhe plotësimet 01. nr. 016-28448 të datës 22.03.2018, nenin 21 të Rregullores 01.Nr.016-126422 të datës 29.12.2016 për kushtet, kriteret dhe proceduat e ndarjes së subvencioneve, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.2/2018, 01. Nr.016-28468 datë 22.03.2018, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në mbledhjen e mbajtur me 18.05.2026, miraton këtë:

V E N D I M
PËR NDAJEN EMJETEVE FINANCIARE NË LARTËSI PREJ 75,000.00€ PËR
SUBVENCIONIMIN E PERSONAVE ME AFËSI TË KUFIZUAR,

1. Miratohet ndarja e mjeteve financiare në lartësi prej 75,000.00€ nga Buxheti i Komunës së Gjiçanit, për subvencionimin programit të punësimit të personave me aftësi të kufizuara në Komunën e Gjiçanit
2. Programi parasheh subvencionimin e pagës mujore për personat me aftësi të kufizuara që punësohen në sektorin privat, në vlerë deri në 250 € në muaj, për një periudhë prej 1 vjeçare, gjysme orari pune(4 ore).
3. Programi do të përfshijë të paktën 25 përfitues, ndërsa kriteret e kualifikimit dhe dokumentacioni i nevojshëm për aplikim dhe përzgjedhja do të bëhet përmes thirrjes publike, që do të publikohet pasi vendimi të bëhet i plotëfuqishëm
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e KK Gjiçan
5. Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës,

01.Nr.016-37345/26
Gjiçan, më 18.05.2026



Kryesuesja e KK Gjiçan,
Latife Kqiku
/Kryesuesja Latife Kqiku/

ARSYETIM

Personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Gjilanit vazhdojnë të përballen me sfida të mëdha në integrimin në tregun e punës, për shkak të mungesës së mundësive dhe mbështetjes institucionale.

Përmes këtij programi synohet:

- krijimi i mundësive të reja për punësim;
- mbështetja e bizneseve lokale që punësojnë këtë kategori;
- rritja e përfshirjes sociale dhe ekonomike;
- përmirësimi i mirëqenies sociale.

Zbatimi i këtij programi pritet të ndikojë drejtpërdrejt në uljen e papunësisë së personave me aftësi të kufizuara dhe në ndërtimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse.

Propozuesi:

Mimoza Kadriu Qerimi

Drejtoreshë në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Date 16.04.2026
